

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Besa Ademi, të mbajtur më 29.04.2024, duke vendosur mbi iniciativën për miratimin e mendimit juridik parimor, të paraqitur nga avokati Ljubomir Mihajllovski dhe avokatja Zhana Kuzmanovska, që të dy nga Shkupi, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa për miratimin e mendimit juridik parimor, e paraqitur nga Ljubomir Mihajllovski – avokat dhe Zhana Kuzmanovska – avokate, që të dy nga Shkupi, e evidentuar nën SU-03.nr.203/24 të datës 13.03.2023, konsiderohet si E TËRHEQUR.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 nga Ligji për gjykatat, avokati Ljubomir Mihajllovski dhe avokatja Zhana Kuzmanovska, që të dy nga Shkupi, paraqitën iniciativë në Gjykatën Supreme të RMV, të evidentuar nën Su-03.nr.203/24 të datës 13.03.2023, për miratimin e mendimit juridik parimor në lidhje me nenin 68 paragrafi (2) të Ligjit për noteri, në lidhje më këtë çështje:

„A duhet të hedhet poshtë si prapësim i paraqitur nga personi i paautorizuar, prapësimi që është paraqitur kundër aktvendimit me të cilin është lëshuar urdhërpagesë noteriale dhe që nuk përmban vulë dhe nënshkrim nga avokati”

Me shkresë SU-03.nr.203/24 të datës 25.04.2024, paraqitësit e tërhoqën iniciativën në tërësi, në mënyrë që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme nxori konkluzion që e njëjta të konsiderohet si e tërhequr.

Seanca e përgjithshme
e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut